



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 717/1 Prot.

Tiranë, më 15 . 04 . 2026

V E N D I M

Nr. 89, Datë 15 . 04 . 2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 203, datë 25.09.2025¹, e znj. V.N kundër Shoqërisë “XH&D Company” shpk², në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes shëndetësore*”³.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Nga muaji gusht 2023 deri në datë 23 prill 2025 kam qenë e punësuar në fabrikën e tekstileve “XH&D Company”. Në janar 2025 pësova një aksident duke rënë nga kati i dytë, pas së cilit u pajisa me raport mjekësor 2-mujor. Pas përfundimit të raportit, u riktheva në punë dhe u takova me pronaren e fabrikës. Nga diskutimet e zhvilluara, u arrit në përfundimin se nuk isha më në gjendje të vazhdoja punën. Pronarja më sugjeroi të drejtohesha pranë zyrës së punës*”

¹ Ankesa është plotësuar me dokumentet e dërguara me email-et datë 03.10.2025 dhe datë 06.10.2025.

² NUIS M36807006T.

³ Referuar Raportit mjekësor për sëmundje që trajtohen nga Komisioni Mjekësor dhe Mbulohen nga Sigurimet Shoqërore, të lëshuar nga Spitali Rajonal Shkodër, datë 22.01.2025, rezulton se ankuesja ka qenë e pajisur me raport mjekësor nga data 22.01.2025 deri në datë 23.03.2025.

për të aplikuar për përfitimin e pagesës së të ardhurave nga papunësia. Me datë 18.04.2025 aplikova në zyrën e punës për të përfituar pagesën e papunësisë, pasi kisha sërish probleme shëndetësore. Me datë 23.04.2025 marrëdhënia e punës u ndërpre në mënyrë të njëanshme. Problematika filloi gjatë procesit të aplikimit për përfitimin e pagesës së të ardhurave nga papunësia. Gjatë kësaj periudhe unë duhej të figuroja e regjistruar në listëpagesën tatimore të subjektit, pavarësisht se kontributet nuk do të paguheshin nga punëdhënësi, pasi pagesa e paaftësisë mbulohej nga shteti. Pra, ligjërisht dhe faktikisht unë duhej të konsiderohesha ende e punësuar. Megjithatë, kompania më hoqi nga sistemi tatimor pa më njoftuar, duke më mohuar kështu të drejtën për të përfituar pagesën e të ardhurave nga papunësia. Për më tepër, mënyra e ndërprerjes së marrëdhënies së punës cenoi parimin e sigurisë juridike dhe përbën shkelje të Kodit të Punës, pasi ajo u krye në mënyrë të njëanshme dhe pa njoftim”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkakun e pretenduar.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1349/1, datë 07.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqëria “XH&D Company”, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Kopje të dosjes personale të ankueses (kontratë pune, kopje të librezës së punës, masa disiplinore, etj).
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit të pagesës së pagës dhe sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore të ankueses për periudhën nga data 01.12.2024 deri në përfundim të marrëdhënies së punës.
 - Kopje të plotë të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen (njoftim, procesverbal takimi, zgjidhje e kontratës së punës, etj).
 - Kopje të Rregullores së Brendshme të Shoqërisë.

Me shkresën datë 13.10.2025, Shoqëria “XH&D Company”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pas shqyrtimit të situatës dhe dokumentacionit zyrtar të lidhur me këtë rast, konstatohet se nuk ka elementë të diskriminimit mbi bazën e gjendjes shëndetësore, pasi vendimet e ndërmarra nga ana e subjektit kanë qenë të mbështetura në rrethana faktike dhe në kërkesat e vetë punonjësës.*

Konkretisht: Znj. V.N ka qenë në raport mjekësor për një periudhë dy mujore dhe është rikthyer në vendin e punës me datë 23.03.2025.

Pas mbarimit të raportit me datë 23.03.2023, punonjësja nuk është paraqitur në punë dhe është informuar se do shkëputet nga puna, pasi subjekti po paguante sigurimet e punonjësit, ndërkohë që nuk paraqitej në punë.

Pas kësaj periudhe, znj. V.N ka kërkuar vetë të ndërpritet marrëdhënia e punës, duke na kërkuar plotësimin e librezës së punës dhe dokumentacionin për aplikimin e saj për përfitimin e pagesës së të ardhurave nga papunësia, në zyrën përkatëse të punës.

Me datë 23.04.2025, marrëdhënia e punës është ndërprerë zyrtarisht. Theksojmë se:

Znj. V.N nuk është diskriminuar për gjendjen e saj shëndetësore, përkundrazi janë respektuar të gjitha të drejtat e saj si punonjëse. Ajo është trajtuar në mënyrë të barabartë me çdo punonjës tjetër.

Të gjitha raportet mjekësore të paraqitura prej saj janë paguar nga ana jonë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontributet janë derdhur rregullisht në sistemin përkatës.

Në dokumentet zyrtare rezulton që znj. V.N ka qenë në marrëdhënie pune deri në datën 23.04.2025, dhe nuk ka pasur asnjë ndërprerje të njëanshme apo penalizuese nga ana jonë.

Znj. V.N ka qenë e aftë për punë që me datë 24.03.2025 dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë 1 muaj më vonë, pra zonja nuk ka pasur probleme shëndetësore në këtë periudhë, gjë që e hedh poshtë pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore”.

- Me shkresën nr. 1349/2, datë 07.10.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Shkodër, lidhur me:
 - Informacionin dhe kopje të dokumentacionit që disponohet nga ana juaj, në lidhje me aplikimin e znj. V.N.
 - Arsyet e mospërfitimit të pagesës së papunësisë, të znj. V.N.

Me shkresën nr. 815/1, datë 10.10.2025, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Shkodër, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Znj. V.N është regjistruar për herë të parë në Zyrën e Punës në datë 18.04.2025. Rasti në fjalë është ndjekur e trajtuar me korrektësi konform bazës ligjore:*

- *Ligji nr. 146/2015 “Për Punëkërkuuesin”.*
- *VKM Nr. 161/2018 “Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia”, i ndryshuar.*
- *Udhëzimi nr. 33/2023 “Për zbatimin e VKM 161/2018”.*
- *Udhëzimi nr. 888/2024 “Për mënyrën e zbatimit të pagesës së papunësisë”.*

Znj. V.N është paraqitur pranë sportelit të shërbimeve të punësimit respektivisht me datë 18.04.2025, 22.04.2025 dhe 25.04.2025, ku i është bërë e qartë që për arsyen e mosderdhjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të plota nga punëdhënësi XH&D Company, brenda afatit ligjor të trajtimit të pagesës së papunësisë (60 ditë kalendarike nga data e shkëputjes së marrëdhënieve të punës) nuk plotëson kriteret për përfitim të pagesës së papunësisë.

Kërkesa në e-albania, nga znj. V.N “Aplikim për përfitim të pagesës së papunësisë, është bërë në datë 12.05.2025.

Data e shkëputjes nga puna në subjektin XH&D Company është 23.04.2025, dhe e drejta për përfitimin e kësaj pagese konform bazës ligjore të cituar më sipër përfundoi në datë 22.06.2025.

Specialisti konform bazës ligjore ka kryer Refuzimin në datë 23.06.2025, duke njoftuar njëkohësisht qytetaren Znj. V.N, për arsyen e Refuzimit “ Mospagim i kontributeve shoqërore brenda afatit të përfitimit të kësaj pagese.

Nga vlerësimi ynë si Zyrë Pune, duke ndjekur hap pas hapi bazën ligjore, e konsiderojmë të trajtuar korrekt procesin e rastit në fjalë”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1349/5, datë 05.12.2025 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 15.12.2025. Me njoftim marrje të Postës Shqiptare, jemi vënë në dijeni se subjekti Shoqëria “XH&D Company” shpk, nuk ka marrë dijeni për shkresën e Komisionerit, për arsye se është larguar. Me shkresën nr. 13, datë 05.01.2026 Komisioneri njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 16.01.2026. Me email-in datë 12.01.2026, Shoqëria “XH&D Company” shpk, ka njoftuar se administratori i shoqërisë për arsye personale ndodhet jashtë vendit dhe ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore. Me e-mail-in datë 14.01.2026, Inspektori i çështjes ka njoftuar palët për shtyrjen e seancës dëgjimore për tu zhvilluar në datë 05.02.2026, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datë 05.02.2026, me praninë e subjektit ankues znj. V.N dhe motra e saj, znj. Gj.N dhe përfaqësuesve të Xh&D Company, znj. S.G, drejtuese prodhimi dhe Av. L.K.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Në muajin janar 2025 jam aksidentuar dhe jam trajtuar me raport mjekësor deri në datë 23.03.2025. Pas kësaj date mjeku nuk më dha raport mjekësor. Pastaj kam vajtur tek kompania për të vazhduar punë dhe kam punuar tre ditë, por kam ndjerë se nuk isha në gjendje për të vazhduar punë. Në muajin prill, pronarja më tha se do të më ndihmojë për të fituar pagesën e papunësisë. Pastaj kam bërë kërkesë për pagesën e papunësisë tek zyra e punës. Për dy muaj kompania nuk derdhi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe për këtë arsye, mu refuzua aplikimi për përfitimin e pagesës së të ardhurave nga papunësia”.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Kompanisë Xh&D, i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, dhe në mes të tjerash deklaroi se: “Ankuesja ka punuar pranë kompanisë për rreth pesë vite. Në muajin janar, ankuesja ka pasur një aksident dhe nuk ka dalë në punë deri në datë 23.03.2025. Deri në datë 23.04.2025 e kam mbajtur ankuesen në punë pa dalë në punë dhe i kam paguar sigurimet shoqërore, por jo pagën,

pasi nuk dilte në punë. Gjatë kësaj periudhe kam komunikuar në telefon, duke e pyetur nëse do dilte në punë dhe më është përgjigjur se nuk mund të dalë në punë se nuk është në gjendje të punojë. Për ta ndihmuar punonjësen i kam thënë se po ta shkruaj si shkurtim i vendit të punës, që të përfitonte pagesë papunësie, por nuk e dija nëse përfitonte apo jo. Ankuesja nuk e ka përfituar pagesën e papunësisë sepse deklarimet e kompanisë ishin, por sigurimet ishin të paderdhura në atë moment, sepse kisha një problem me pagesat e porositësve Italianë. I kam thënë ankueses se nuk mund të paguaj sigurimet individuale, sepse nuk lejohet, pasi duhen paguar sigurimet për të gjithë punonjësit në total. Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të asaj periudhe nuk janë paguar për asnjë punonjës, jo vetëm për ankuesen. Pagesat e sigurimeve për muajt prill-qershor, për të gjithë punonjësit dhe për ankuesen, janë bërë në muajin korrik 2025”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të pafavorshëm dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi më pak të favorshëm dhe të pabarabartë, në të drejtën e saj për të përfituar pagesën e të ardhurave nga papunësia, pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, nga parashtrimet e palëve, si dhe nga informacioni i dërguar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale Shkodër, rezulton se znj. V.N ka qenë në marrëdhënie pune pranë shoqërisë “XH&D Company” shpk, deri në datën 23.04.2025, ndërsa për periudhën 22.01.2025–23.03.2025, ka qenë e pajisur me raport për paafësi të përkohshme në punë.

Po ashtu, rezulton se ankuesja është paraqitur pranë AKPA, Drejtoria Rajonale Shkodër në datat 18.04.2025, 22.04.2025 dhe 25.04.2025, ndërsa kërkesa në e-albania për përfitimin e pagesës së të ardhurave nga papunësia, është bërë në datën 12.05.2025.

AKPA, Drejtoria Rajonale Shkodër ka refuzuar përfitimin e të ardhurës nga papunësia për ankuesen, duke arsyetuar se brenda afatit ligjor nuk ishin derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi. Edhe vetë subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa ka pranuar gjatë seancës dëgjimore se kontributet për muajt përkatës nuk ishin paguar në kohën e duhur dhe se ato janë likuiduar në muajin korrik 2025.

Në këtë kuadër, Komisioneri evidenton se ligji nr. 146/2015 “Për punëkërkuesit” ka për objekt rregullimin e procesit të regjistrimit të punëkërkuesve në zyrat e punësimit dhe lidhjen e tyre me të drejtat dhe shërbimet përkatëse, ndërsa neni 4, pikat 1 dhe 2, parashikon se zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron çdo person që është në moshë për punë, i aftë dhe i gatshëm për punë, dhe vendos për dhënien ose jo të statusit të punëkërkuesit pas verifikimeve përkatëse.

Po në të njëjtin nen, pika 3, parashikon detyrimin e punëkërkuesit të regjistruar për t'u paraqitur periodikisht pranë zyrës së punësimit.

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 2 përcakton se sigurimi shoqëror i detyrueshëm mbron me të ardhura personat e punësuar edhe në lidhje me papunësinë. Po ky ligj, në nenin 13, pika 3, parashikon shprehimisht se: *“Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t'i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003, të ndryshuar”*. Ndërsa neni 53, pika 1, përcakton se: *“Personat e siguruar përfitojnë të ardhura papunësie nëse: a) kanë kontribuar në sigurimin shoqëror jo më pak se 12 muaj për çdo rast përfitimi; b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës si punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen kur iu ofrohet punë e paguar, e përshtatshme; pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen; c) nuk marrin përfitime të tjera nga ky ligj, me përjashtim të pensionit të pjesshëm të invaliditetit”*. Më tej, nenet 54 dhe 55 të po këtij ligji rregullojnë respektivisht shumën dhe periudhën e përfitimit të së ardhurës nga papunësia.

VKM nr. 161, datë 21.03.2018 *“Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”*, i ndryshuar, në pikën 2 përcakton se: *“Përfitojnë të ardhura nga papunësia të gjithë personat e siguruar, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar”*. Në pikën 3 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Nuk përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët: a) ndërpresin aktivitetin si punëdhënës dhe të vetëpunësuar; b) largohen nga puna me dëshirën e tyre; c)”*.

Në pikën 6 të VKM-së përcaktohet se: *“Personat të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, duhet të paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon: a) Kërkesë për aplikim; b) Librezë pune; c) Dokument identiteti (fotokopje); ç) Vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, dhe vërtetim për personat që ndjekin arsimin e lartë apo janë vlerësuar me aftësi të kufizuar, sipas komisioneve përkatëse, deri në moshën 25 vjeç; d) Nëse është rasti, vërtetim nga dega e tatimtaksave dhe sigurimeve shoqërore, të gjeneruar nëpërmjet portalit qeveritar e-albania, për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga 1.1.1994 deri më 31.12.2011, sipas shkronjave “a” “b”, “c” e “ç”, të pikës 4”*.

Në vijim, Udhëzimi nr. 33, datë 20.12.2023 *“Për mënyrën e zbatimit të VKM nr. 161, datë 21.3.2018”*, i ndryshuar, në pikën 1 përcakton kumulativisht kushtet që duhet të plotësohen për përfitimin e të ardhurës nga papunësia, konkretisht: *“a) të ketë kontribuar në sigurimin shoqëror si punëmarrës për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi; b) personi të jetë regjistruar si punëkërkues i papunë pranë strukturës vendore përkatëse të punësimit; c) të ketë paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin sipas pikës 6, të vendimit nr. 161/2018, të ndryshuar, për të përfituar të ardhurën nga papunësia, pranë strukturës vendore përkatëse brenda 60 ditëve”*

kalendarike nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punësimit me punëdhënësin”. Po kështu, pika 3, shkronja “a”, parashikon se: *“Kategoritë përfituese të pagesës së të ardhurës nga papunësia janë: a) Të gjithë personat të cilët kanë kontribuar si punëmarrës në sigurimet shoqërore për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi; ndërsa në shkronjën “ç”, të këtij udhëzimi parashikohet se: “Personat, të cilët janë shkëputur nga puna për arsye të përfitimit të paaftësisë së përkohshme dhe, pas mbarimit të kësaj periudhe, në momentin që kthehen në vendin e punës, u ndërpritet marrëdhënia individuale e punës”*.

Nga analiza e këtij kuadri normativ, rezulton se e drejta për të përfituar pagesën e së ardhurës nga papunësia, kushtëzohet jo vetëm nga regjistrimi si punëkërkuar i papunë dhe nga paraqitja në afat e kërkesës, por edhe nga ekzistenca e kontributeve të derdhura si punëmarrës, sipas kritereve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore. Po ashtu, rezulton se detyrimi për derdhjen e këtyre kontributeve nuk rëndon mbi punëmarrësin, por mbi punëdhënësin, i cili, sipas nenit 13, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, është subjekti i ngarkuar nga ligji për llogaritjen, mbajtjen dhe pagesën e tyre.

Në rastin konkret, AKPA, Drejtoria Rajonale Shkodër, ka informuar Komisionerin se ankuesja nuk plotësonte kriteret për përfitimin e pagesës së papunësisë, për shkak se kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nuk ishin derdhur nga punëdhënësi brenda afatit ligjor të trajtimit të pagesës së papunësisë, pra brenda 60 ditëve kalendrike nga data e shkëputjes së marrëdhënies së punës, afat i cili në rastin e znj. V.N përfundonte në datë 22.06.2025. Për këtë arsye, refuzimi është kryer në datë 23.06.2025.

Komisioneri vëren se, pavarësisht se mosderdhja në kohë e kontributeve të sigurimeve lidhet me vështirësi financiare të punëdhënësit apo me shkaqe të tjera të brendshme të tij, pasoja juridike e këtij mosveprimi ka rënduar mbi ankuesen. Vetë subjekti ka pranuar se mosderdhja e kontributeve nuk ka qenë e lidhur me ankuesen individualisht, por me një vështirësi financiare të përgjithshme të shoqërisë dhe se pagesat janë kryer më vonë për të gjithë punëmarrësit.

Kjo rrethanë përjashton ekzistencën e një trajtimi të diferencuar individual ndaj ankueses, sepse pasoja e mosderdhjes së kontributeve ka qenë rezultat i një situate të përgjithshme financiare të kompanisë dhe jo i një veprimi të drejtuar posaçërisht kundër ankueses për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Komisioneri vlerëson se në çështjen konkrete mund të ngrihen problematika që lidhen me korrektësinë e përmbushjes së detyrimeve të punëdhënësit në raport me kontributet dhe me pasojat që kjo ka sjellë në përfitimin e pagesës së papunësisë nga ankuesja. Megjithatë, këto rrethana, edhe nëse mund të jenë relevante nga pikëpamja e legjislacionit të punës apo e detyrimeve të punëdhënësit, nuk mjaftojnë në vetvete për të provuar diskriminim.

Po kështu, rezulton se raportet mjekësore të paraqitura nga ankuesja janë paguar sipas legjislacionit në fuqi dhe se ankuesja në dakordësi me punëdhënësin nuk është paraqitur në punë

pas përfundimit të raportit mjekësor, si dhe ajo është këshilluar/ndihmuar nga vetë punëdhënësi se mund të aplikonte për përfitimin e pagesës së papunësisë. Punëdhënësi pavarësisht se ankuesja nuk ka dalë në punë për më shumë se tre javë gjatë muajit prill, përsëri e ka deklaruar në listëpagesë, dhe i ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore edhe për muajin prill 2025.

Këto elemente, të marra së bashku, nuk provojnë se punëdhënësi ka ndërmarrë një masë të lidhur drejtpërdrejt me gjendjen e saj shëndetësore, në kuptimin e trajtimit të pafavorshëm dhe diskriminues.

Në vlerësim të sa më sipër, Komisioneri çmon se shkak i drejtpërdrejtë i mospërfitimit të pagesës së të ardhurave nga papunësia ka qenë mosderdhja në kohë e kontributeve, siç është konstatuar nga struktura përkatëse e punësimit, dhe jo ekzistenca e një trajtimi të pabarabartë të ankueses për shkak të gjendjes shëndetësore.

Komisioneri vëren se nga provat e administruara nuk rezulton se ankuesja është trajtuar ndryshe nga punonjësit e tjerë të kompanisë, përsa i përket derdhjes së vonuar të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pasi vetë shoqëria ka deklaruar se kontributet nuk janë paguar në afat për asnjë punonjës të asaj periudhe. Në mungesë të një elementi krahasues që të evidentojë se ankuesja është veçuar apo është vendosur në një pozitë më të pafavorshme sesa punëmarrës të tjerë, ky trajtim i pafavorshëm nuk mund të konsiderohet, vetëm për këtë arsye, si trajtim i pabarabartë në kuptimin të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, të ndryshuar.

Për rrjedhojë, Komisioneri çmon se në rastin konkret provohet ekzistenca e një pasoje negative të ardhur ankueses, si rezultat i mosrespektimit nga punëdhënësi të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i sigurimeve shoqërore dhe skema e pagesës së papunësisë, por gjithashtu rezulton se nga punëdhënësi janë ndërmarrë veprime pozitive dhe se pagesa e detyrimeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore është kryer në muajin korrik, për të gjithë punonjësit e kompanisë, përfshirë dhe ankuesen.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimi e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Në nenin 12/1/c) të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim.*

Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Sa më sipër, mbështetur në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, referuar provave të administruara nuk rezultoi se ankuesja është vendosur në pozita të pabarabarta nga ana e Shoqërisë “XH&D Company” shpk, sa i përket marrëdhënieve të punësimit.

Në mungesë të trajtimit të pabarabartë të subjektit ankues, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë të saj, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun” e pretenduar.

Komisioneri, vlerëson se për sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të ligjit 10221/2020 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga ana e Shoqërisë “XH&D Company” shpk, lidhur me trajtimin e ankueses, gjatë marrëdhënieve të punësimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të znj. V.N nga ana e Shoqërisë “XH&D Company” shpk.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA